



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2024:285600

Datë: 25.10.2024

Numri i dokumentit: 06353179

P.nr.354/24

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEGA NË LIPJAN, Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal, në përbërje prej gjyqtarës së vetme gjykuese Benita Berisha, me pjesëmarrjen e bashkëpuntorit profesional Visar Zeqiri, duke vendosur në çështjen penale kundër të pandehurit F. M. nga Prishtina rr. "A. G.", të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.1777/24, të datës 30.09.2024, për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 313 par. 2 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, jashtë seancës, me datën 25.10.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-së në Prishtinë, PP.II.nr.1777/24, të datës 30.09.2024, dhe kjo gjykatë konform dispozitës të nenit 495 të KPP-së, jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Kundër të pandehurit:

F. M., i lindur me datën *data e lindjes...*, në fshatin O., tani me vendbanim në Prishtinë rr. "A. G.", nga i ati H. dhe nëna F., e gjinisë M., i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal-*numri...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE:

Me datë 17.09.2023 në periudhën kohore mes orës 21:00 deri 02:32 pas mesnate, në fshatin G. e E. K. Lipjan, e saktësisht në rrugën "E. 99", i pandehuri F. M. me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit ti sjell përfitim të kundërligjshëm, ka vepruar në atë mënyrë që nga automjeti i tipit "Opel Astra", ngjyrë hiri, me numër të targave *numri...*, i cili ka qenë i parkuar, ka arritur ti marr targat e këtij automjeti në mënyrë që të njëjtat ti shfrytëzoj për kryerjen e një vepre penale të grabitjes, me çka të dëmtuarit pronarit të këtij automjeti H. A. i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 40 euro,-

-me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja nga neni 313 par. 2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 1, 2, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69 dhe nenit 313 par. 2 të KPRK-së, si dhe neneve 364, 449, 452, 462, 493 dhe 495 të KPPK-së, e gjykon me:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **1500.00.-€**, (njëmijë e pesë qind euro), të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguaj, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj me dënim me burgim, duke i llogaritur për çdo 20 € (njëzet euro) gjobë me një (1) ditë burgim.

OBLIGOHET i pandehuri që kësaj gjykate në emër të paushallit gjyqësor t'i paguaj shumën prej 20-€, si për kompensimin e viktimave të krimit t'i paguaj shumën prej 20-€ pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm, në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar: H. A. nga fshati G. e E. K. Lipjan, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën e saj PP.II.nr.1777/24, të datës 30.09.2024, e ka akuzuar të pandehurin F. M. nga Prishtina rruga "A. G.", për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 313 par. 2 të KPRK-së dhe në të njëherit ka kërkuar nga gjykata që të pandehurit t'i shqiptohet urdhër ndëshkimor-dënim me gjobë për veprën e lartcekur penale.

Gjyqtarja e vetme gjykuese pasi shqyrtoi provat që i janë bashkangjitur aktakuzës respektivisht kallëzimit penal me numër të rastit 20232-AH-0933, të datës 25.03.2024, deklarata e të dëmtuarit-dëshmitarit H. A., e datës 18.03.2023, deklarata e të pandehurit F. M., e datës 19.03.2024, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes nga njësia e forenzikës, foto dokumentacioni, si dhe shkresat tjera të lëndës, erdhi në përfundim se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës, në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, prandaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me dispozitën e nenit 493 të KPPK-së parashihet se "Për vepra penale për të cilat parashihet dënim me gjobë ose burgim deri në tri (3) vjet, për të cilat prokurori i shtetit është informuar në bazë të provave të besueshme nga kallëzimi penal, prokurori i shtetit mund të kërkojë në aktakuzë që gjykata të jep urdhër ndëshkimor, në të cilin të akuzuarit do ti shqiptojë dënim përkatës pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor".

Gjyqtarja me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes konform nenit 495 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për shqyrtimin e urdhrit ndëshkimor ndaj të akuzuarit nga arsyet se dënimi për veprën penale me të cilën ngarkohet i akuzuari është dënim me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj, andaj gjykata konform dispozitave të lartcekura vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke konsideruar se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor u bazua konform nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 dhe nenit 452 par.1 të KPPK-së, ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të

krimin u mor në bazë të nenit 36 par. 3 nën par 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimin.

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore-juridike, u bazua konform nenit 462 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEGA NË LIPJAN
Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr. 354/24, me datën 25.10.2024.

Bashkëpunatori Profesional
Visar Zeqiri

G J Y Q T A R J A
Benita Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri ose mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim, në afat prej 8 (tetë) ditëve, nga dita e pranimit të tij. Kundërshtimi i parashtrohet kësaj Gjykate.